

# **Raport Monitorimi i realizimit të zbatimit të Planit të Integritetit 2023**

**Bashkia Kukës**

## Përmbajtja

<b>I. Hyrje</b> .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>I. Monitorimi i PI për bashkinë Kukës Viti 2023</b> .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>I.1 Qasja Vlerësuese</b> .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>I.2 Metodologjia e vlerësimit</b> .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>I.3 Mbledhja dhe analiza e të dhënave</b> .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>II. Gjetjet e Raportit</b> .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>III. Konkluzione dhe Rekomandime</b> .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## Lista e Figurave

Figura 1: Statusi i Zbatimit të Masave.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Figura 3: Statusi i Zbatimit të Masave, Objektivi I.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Figura 4: Statusi i Zbatimit të Masave, Objektivi II.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Figura 5: Statusi i Zbatimit të Masave, Objektivi III.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## Hyrje

Integriteti institucional dhe lufta kundër korrupsionit konsiderohen si një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare. Në kontekstin e sektorit publik, integriteti konsiston në përmbushjen e detyrimeve të transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe efikasitetit në kryerjen e detyrave dhe të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe administrative.

Miratimi dhe monitorimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore është jetësuar nëpërmjet koordinimit dhe zbatimit të nismave anti-korrupsion të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) 2015-2023. Ndërkohë menaxhimi i riskut të integritetit për NJVV-të, si proces në vetëvete rrjeth nga objektivi specifik (objektivi A11) i SNKK dhe Planit të Veprimit (2018-2023), miratuar me VKM nr.516, datë 1.7.2020, si dhe qëllimit politik 5 të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-20230 (SNDQV) - objektivi specifik 5.2: “Nxitja e politikave kundër korrupsionit në nivel vendor dhe konsolidimi i mëtejshëm i arritjeve mbi integritetin”, miratuar me VKM nr.252, datë 21.04.2023”. Ky proces vjen në linjë edhe me rekomandimet e Komisionit Evropian (2018) për Shqipërinë në kuadër të integritetit në Bashkimin Evropian, ku një nga rekomandimet e dhëna është zbatimi i dokumentit të Strategjisë Kundër Korrupsionit, duke iu referuar konkretisht mungesës së një sistemi funksional të menaxhimit të integritetit në institucionet publike në vend.

Procesi i menaxhimit të riskut të integritetit në nivel vendor, ka një qasje gjithëpërfshirëse ku angazhohen të gjitha strukturat e brendshme të bashkisë. Ndërsa hapi i parë i tij lidhet me hartimin e Planit të Integritetit për njësinë vendore (detajuar ky i fundit edhe me një Plan Veprimi 3-vjeçar), monitorimi dhe raportimi i planit të integritetit është etapa tjetër e menaxhimit të riskut në bashki. Monitorimi është periodik (çdo vit) dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve dhe drejtuesve të bashkisë, për zbatimin e masave të miratuara për trajtimin e risqeve, në përputhje me përgjegjësitë që ata kanë. Ndërkaq raportimi është një procedurë e rregullt që siguron zbatimin e Planit të Veprimit për risqet e integritetit, sipas afateve kohore të parashikuara, për periudhën e kërkuar, përv statusin e zbatimit të tyre për problematikat e hasura në zbatim si dhe përmban të dhëna për veprimtarinë e brendshme kontribuese, referuar kuadrit të brendshëm rregullator, burimeve njerëzore profesionale e të qëndrueshme si dhe transparencës dhe komunikimit me grupet e interesuara.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) në kuadër të funksioneve të saj për realizimin e objektivave të Qeverisë Shqiptare për garantimin e qeverisjes së mirë, ka vijuar me procesin e monitorimit të zbatimit të planeve të integritetit në nivel bashkie për vitin 2023. Raporti i monitorimit është hartuar në përputhje me metodologjinë e monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qëndrore. Analiza e të dhënave dhe vlerësimi i progresit të zbatimit të Planit të Veprimit të Planit të Integritetit për këtë periudhë raportimi është bërë në zbatim të Urdhrit nr. 553, datë 30.09.2021 “*Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qëndrore*”.

## Raporti i Monitorimit të PI për bashkinë Kukës Viti 2023.


Për periudhën janar-dhjetor 2023, Plani i Integritetit të bashkisë Kukës ka të parashikuar për zbatim 55 masa/aktivitete të shpërndara në tre objektiva, përkatësisht:

- **Objektivi I** Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë;
- **Objektivi II** Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- **Objektivi III** Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit

Nga monitorimi i planit të veprimit rezulton se në totalin prej 55 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2023 janë **zbatuar** 31 masa/aktivitete ose 56% **në proces zbatimi** 17 masa/aktivitete ose 31% dhe **të pazbatuara** 7 masa/aktivitete ose 13%..

Bashkia Kukës	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të parealizuara
Realizimi ne total I objektivave te PI		55	31	17	7

### STATUSI I ZBATIMIT TË MASAVE



## **Qasja Vlerësuese**

Raporti i monitorimit të zbatimit të planit të integritetit të bashkisë Kukës, përmban një analizë të përgjithshme të zbatueshmërisë dhe progresit të vitit 2023 për masat/aktivitete në drejtim të karakterit rregullator të performancës institucionale, menaxhimit të burimeve njerëzore si dhe riskut në fusha të vecanta të përgjegjësisë për ti rezistuar shkeljeve të integritetit si dhe çështjeve të ndryshme të organizimit dhe funksionimit të strukturave teknike të bashkisë.

## **Metodologjia e vlerësimit.**

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të dhënë nga drejtoritë dhe strukturat teknike të bashkisë Kukës bazuar në aktivitetet dhe masat e parashikuara për zbatim për vitin 2023 në planin e veprimit të Planit të Integritetit.

## **Mbledhja dhe analiza e të dhënave.**

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga Koordinatori i Integritetit të bashkisë Kukës në përmbushje të rolit të tij përgjegjës për mbledhjen dhe analizën e informacionit mbi monitorimin e Planit të integritetit.

## **Gjetjet e Raportit**

### **Objektivi I “Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë”**


Përmes këtij objektivi synohet identifikimi dhe vlerësimi i risqeve të integritetit në Bashki, të cilat hasen më së shumti në fusha të veçanta të përgjegjësisë e cila paraqet sfida në drejtim të fushës së menaxhimit financiar, menaxhimit të pronave të bashkisë, shërbimeve publike si dhe planifikimit të territorit.

Ky objektivi për vitin 2023 përmban 13 masa/aktivitete specifike të planifikuara për tu zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen kuadrit rregullator të brendshëm të integritetit në fusha të vecanta të përgjegjësisë së bashkisë , si fusha e menaxhimit financiar, shërbimeve publike, planifikimi i teritorit, menaxhimi dhe administrimit të pronave,etj.

Gjatë periudhës raportuese nga 13 masa/aktivitete të planifikuara, janë realizuar 7 masat/aktivitetet ose 54%, janë në proces 4 masa/aktivitete ose 31% dhe nuk janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 15% sipas tabelës dhe grafikut, si më poshtë:

Objektivi I	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të parealizuara
Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë		13	7	4	2

### REALIZIMI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE



Për këtë periudhë monitorimi Janar-Dhjetor 2023 evidentohet se bashkia ka realizuar me sukses masat dhe aktivitete si më poshtë:

- Koordinim i vazhdueshëm për respektimin e kalendarit të hartimit dhe miratimit të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor nga të gjitha palët e përfshira.
- Zhvillimi i konsultimeve të zgjeruara me banoret e bashkisë dhe njësive administrative gjatë përcaktimit të prioriteteve për të siguruar përputhshmëri sa më të lartë të buxhetit dhe nevojave të komunitetit, <https://kukesi.gov.al/njofime-mbi-degjesat-publike/>

- Kontrolle periodike nga eprorët përkatës në lidhje me respektimin e procedurave të thesarit për kontrollin e shpenzimeve;
- Monitorimi i buxhetit bazuar në informacionin e viteve të kaluara dhe vitit buxhetor aktual dhe propozimi i ndryshimeve përkatëse në KB;
- Hartimi dhe miratimi i Strategjisë për Menaxhimin e Riskut.  
<https://kukesi.gov.al/organizimi-administrativ/>
- Publikimi i bazës së taksave dhe tarifave, si dhe niveli i tyre, çdo përjashtim apo ulje, afati i pagesave, si dhe gjobat e kamatëvonesat e aplikueshme, tek seksioni përkatës në Programin e Transparencës së Bashkisë <https://kukesi.gov.al/ep-content/uploads/2023/01/Paketa-Fiskale-2023.pdf>
- Publikimi i PDV-së në Programin e Transparencës. <https://kukesi.gov.al/sherbimet-qe-ofron-bashkia/>
- Rishikim i informacionit publik në Programin e Transparencës në lidhje me lejet e ndërtimit <https://kukesi.gov.al/planifikim-i-territorit>


**Objektivi II** “*Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;*”

Përmes këtij objektivi synohet rishikimi i kuadrit rregullator duke shtuar dispozita të caktuara, kryesisht ato që lidhen me aspektet dhe çështjet e integritetit, përditësimit me ndryshimet më të fundit ligjore, si edhe pasqyrimin të ndryshimeve që ka pësuar struktura institucionale. Përmes këtij objektivi synohet forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të vecanta të etikës dhe integritetit.

Gjatë periudhës raportuese nga 17 masa/aktivitete të planifikuara për zbatuar, janë realizuar 10 masat/ aktivitetet ose 58%, janë në proces 4 masa/aktivitete ose 23% dhe nuk janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 19% sipas tabelës dhe grafikut, si më poshtë:

Objektivi II	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara per vitin 2023	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht tërealizuara	Masa dhe aktivitete te porealizuara
Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit		17	10	4	3

## REALIZIMI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE



Për këtë periudhë monitorimi Janar Dhjetor 2023 bashkia ka realizuar me sukses masat dhe aktivitetet si më poshtë:

- Parashikimi në Rregulloren e Brendshme i detyrave dhe përgjegjësi të koordinorit për të drejtën e informimit dhe linjat e komunikimit me strukturat e tjera, afatet dhe përgjegjësitë për kthimin e përgjigjeve <https://kukesi.gov.al/kerkesat-per-informim>
- Organizimi i takimeve ndërgjegjësuere /informuese me personelin e bashkisë mbi detyrimet që rrjedhin nga ligji për të drejtën e informimit. Përfshirja e tyre në planin vjetor të trajnimeve.
- Organizimi i takimeve ndërgjegjësuere /informuese me personelin e bashkisë mbi detyrimet që rrjedhin nga ligji për njoftimin dhe konsultimin publik. Përfshirja e tyre në planin vjetor të trajnimeve
- Hartimi dhe miratimi i rregullave të brendshme të funksionimit të GMS-së si organ kolegjal në Bashki, si dhe përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësi përkatëse.
- Miratimi i formularëve për sinjalizimin dhe formularët për kërkesën për mbrojtjen nga hakmarrja sipas modelit të ILDKPKI-së. <https://kukesi.gov.al/ep-content/uploads/2022/05/Caktimi-i-Anetarit-te-Struktures-Pergjegjese-per-Sinjalizimin.pdf>

**Objektivi III** “Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit”


Ky objektivi synon të forcojë mekanizmat që lidhen me garantimin e integritetit në nivelin e proceseve të punës duke përmirësuar menaxhimin dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë me qëllim, rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve në përputhje me performancën në punë.



Gjatë periudhës raportuese nga 25 masa/aktivitete të planifikuara për zbatuar, janë realizuar 14 masat/ aktivitetetose 56%, janë në proces 9 ose 36% dhe nuk janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 8% sipas tabelës dhe grafikut, si më poshtë:

Objektivi III	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara per vitin 2023	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të parealizuara
Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit		25	14	9	2

#### REALIZIMI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE



Për këtë periudhë raportimi nga realizimi i masave dhe aktiviteteve janë arritur rezultate në këto drejtime:

- Organizimi i takimeve informuese me personelin e bashkisë për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë;
- Përfshirja e tyre në Planin Vjetor të Trajnimeve;
- Përcaktimi në Rregulloren e Brendshme i detyrimit për hartimin e Planit Vjetor të Trajnimeve;
- Përcaktimi në Rregulloren e Brendshme i detyrimit për kryerjen e Analizës Vjetore të Performancës, si bazë për identifikimin e nevojave për trajnim dhe Hartimin e Planit Vjetor të Trajnimeve;
- Organizimi i trajnimeve për personelin e bashkisë në lidhje me parandalimin dhe deklarimin e konfliktit të interesit si dhe kuadrin ligjor e rregullator përkatës <https://kukesi.gov.al/ep-content/uploads/2022/05/Rregullore-Per-konfliktin-e-interesave.pdf>
- Marrja e masave të nevojshme për rekrutimin e burimeve njerëzore të mjaftueshme për Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit;
- Organizimi i trajnimeve me stafin e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me qëllim njohjen me ndryshimet legjislative përkatëse. Përfshirja e tyre në Planin Vjetor të Trajnimeve;
- Publikimi i raportit të përmbledhur mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve në Programin e Transparencës; <https://kukesi.gov.al/transparenca-dhe-llogaridhenia-ef/>
- Zbatim i kuadrit ligjor për mbrojtjen e privatësisë gjatë publikimit në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve <https://kukesi.gov.al/ep-content/uploads/2024/01/Regjistri-Kerkesave-dhe-Pergjigjeve-2023.pdf>
- Përditësimi periodik i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve; <https://kukesi.gov.al/kerkesat-per-informim/>
- Plotësimi i Programit të Transparencës në përputhje me detyrimet ligjore mbi informacionin që bëhet publik pa kërkesë, duke u siguruar që informacioni të jetë i plotë, lehtësisht i aksesueshëm, i përditësuar, i kuptueshëm, lehtësisht i përdorshëm nga qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile;
- Plotësimi dhe përditësimi i Programit të Transparencës në lidhje me shërbimet e ofruara nga bashkia, kriteret për përfitimin e tyre, strukturat përgjegjëse, procedurën e ankimimit etj; <https://kukesi.gov.al/sherbimet-qe-ofron-bashkia/>

### **Hapa të tjera:**

- Të publikohen në programin e transparencës së bashkisë raportet e auditit sipas duke respektuar zbatimin sipas procedurave ligjore.
- Të vijojë me promovimin e ngritjes në detyrë, lëvizjes paralele, dhe rekrutimeve të reja sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të parashikuara në ligjin “Për statusin e nëpunësit civil”.
- Në bashkëpunim me Komisionerin për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil të kryhet një analizë lidhur me pozicionet që kategorizohen në shërbimin civil.
- Të vijojë puna për hartimin e procedurave standarde të veprimit lidhur me menaxhimin vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve sipas standardeve kombëtare të kontabilitetit.

## **Konkluzione**

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për vitin 2023, të gjetjeve që document na ofron, të dhënave analitike të raportuara dhe analizës së kryer rezulton se:

Bashkia Kukës ka vijuar me zbatimin e planit të Integritetit duke realizuar një nivel të mesëm (41-60) 56% të realizimit të masave të planifikuara për integritetin (41-60) për vitin 2023,

## **Rekomandime:**

- ✓ Të vijohet me zbatimin dhe raportimin e masave që janë në process apo nuk janë realizuar sipas objektivave të Planit të Integritetit si të etikës, burimeve njerëzore dhe fushave të veçanta të përgjegjësisë;
- ✓ Përmirësimi i kapaciteteve në strukturat përkatëse që meren me zbatimin dhe raportimin sipas metodologjisë së monitorimit të PI;
- ✓ Rritja e transparencës dhe llogaridhënies sipas fushave të ndyshme funksionale në nivel bashkie;
- ✓ Fokusim i posacëmi tek objektivi i përmirësimit të Kornizës rregullatore të bashkisë si element thelbësor që mbështet sistemin e menxhimit të integritetit në bashki
- ✓ Përmirësimi i kapaciteteve në strukturat/institucionet përkatëse për zbatimin dhe raportimin sipas metodologjisë përkatëse të monitorimit
- ✓ Dërgimi brenda afateve të përcaktuara, si dhe në përputhje me format e kërkuara të kontributeve nga strukturat dhe institucionet përgjegjëse